



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
AGJENCIA PËR INFORMIM DHE PRIVATËSI
AGENCIJA ZA INFORMACIJE I PRIVATNOST
INFORMATION AND PRIVACY AGENCY



Nr. A - 1028/2025

Datë: 06.11.2025

Republika e Kosovës Republika Kosova-Republic of Kosovo AGJENCIA PËR INFORMIM DHE PRIVATËSI AGENCIJA ZA INFORMACIJE I PRIVATNOST INFORMATION AND PRIVACY AGENCY	
ZYRA E ARKIVIT - KANCELARIA ARHIVA - ARCHIV	
Njësia Org. Org. Jodi Org. Unit	Nr. i Prot. Er. Prot. Prot. No.
03	1392
Nr. i Faqeve Broj Stranica No. of Pages	Data: Datum Date
03	06 11 2025

Në mbështetje të nenit 21, 26 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, nenit 20 të Ligjit për Qasje në Dokumente Publike, përkitazi me ankesën nr.1028 të parashtruar më datën 01.09.2025 të OJQ 'Çohu', ndaj Ndërmarrjes Publike 'Termokos', për mosofrimin e qasjes në dokumenteve publike, të paraqitur më 08.08.2025 dhe 25.08.2025, Agjencia për Informim dhe Privatësi nxjerr këtë:

V E N D I M

1. **Aprovohet** si e bazuar ankesa e OJQ 'Çohu' ndaj NP 'Termokos'.
2. **Obligohet** NP 'Termokos' që në afat prej 7 ditëve nga data e pranimi të këtij vendimi, t'i ofrojë qasje të plotë ndaj informacioneve të lidhura me mbledhjet e Bordit të 'Termokos' për vitin 2024, si në vijim:
 - 2.1. Pse bordi nuk ka mbajtur mbledhje të tjera në gjashtëmujorin e dytë të vitit 2024 dhe cilat janë arsyet e mbajtjes së vetëm katër mbledhjeve brenda vitit 2024?
 - 2.2. Nëse janë mbajtur mbledhje tjera gjatë gjashtëmujorit të dytë të vitit 2024, kërkohen procesverbalet e mbledhjeve të Bordit të Drejtorëve për vitin 2024.
3. **Obligohet** NP 'Termokos' që ta njoftojë me shkrim Agjencinë, pas marrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.
4. Vendimi hyn në fuqi më datën e pranimi të të njëjtit.

Arsyetim

Në bazë të nenit 20, paragrafi 1, të Ligjit Nr. 06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike, Agjencia ka pranuar një ankesë nga pala OJQ 'Çohu', me nr. të protokollit 1028, të datës 01.09.2025, të ushtruar ndaj NP 'Termokos', për mosofrimin e qasjes në dokumentet publike, të përmendur në pikën 2 të dispozitivit të këtij vendimi.

Institucioni publik, sipas shkresave të bashkëlidhura të palës ankuese, nuk ka ofruar qasje në dokumentet objekt kërkese brenda afatit ligjor.

Në kuadër të fazës fillestare të shqyrtimit të kësaj ankese, autoriteti mbikëqyrës, më 27 tetor 2025 i ka përcjellë institucionit publik një shkresë njoftuese, përmes të cilës, mes tjerash, i ka kërkuar arsyet e mosofrimit të qasjes ndaj informacioneve të kërkuara nga pala ankuese përmes pyetjeve.

Në përgjigjen e institucionit publik të datës 03 nëntor 2025, theksohet se ofrimi i qasjes ndaj informacioneve të kërkuara i tejkalon kompetencat e zyrtarit kryesor administrativ, andaj duhet pritur mbledhjes e radhës së bordit të ndërmarrjes, për të shqyrtuar ofrimin e qasjes për palën ankuese.

Për ta sqaruar çështjen e autoritetit dhe kompetencës për vendimmarrje ndaj kërkesave për qasje në dokumente publike, e veçanërisht rreth përgjegjësisë në procesin e shqyrtimit të një ankese, e cila zhvillohet nga AIP në raport me cilindo institucion publik, AIP, mes tjerash, i ka shpjeguar njësisë përgjegjëse të 'Termokos' që është pikërisht pozita e kryeshefit ekzekutiv (ZKA), e cila merr vendim për çdo kërkesë për qasje në dokumente publike dhe se bordi i ndërmarrjes nuk ka as autorizim as kompetencë për të ndërhyrë në këtë vendimmarrje, pavarësisht që informacionet e kërkuara mund të lidhen me fushëveprimtarinë e këtij bordi.

Më 06 nëntor 2025, 'Termokos' sërish ka përsëritur qëndrimin e ngjashëm, duke mos ofruar qasjen ndaj informacioneve të kërkuara nga pala ankuese, duke i dhënë, në këtë mënyrë AIP-së hapësirë për të vazhduar procedurat e shqyrtimit të ankesës në fjalë.

Pyetjet e qytetarëve, të drejtuara institucioneve publike, trajtohen si kërkesa për qasje në dokumente publike sepse përgjigja ndaj atyre pyetjeve përbën informacion, i cili, sipas përkufizimeve të Ligjit Nr. 06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike (nënparagrafi 1.2 i nenit 3), cilësohet si 'dokument publik'. Rrjedhimisht, nëse përgjigja e institucionit publik ndaj qytetarit është dokument publik (sepse është informatë/informacion), andaj edhe kërkesa e qytetarit për ta marrë atë 'dokument publik', duhet cilësuar si kërkesë për t'u qasur në atë dokument publik.

Përgjigjet e mundshme ndaj pyetjeve të kërkuara lidhen me ushtrimin e funksioneve publike të zyrtarëve publikë (anëtarëve të bordit), të cilat, sipas nënparagrafit 3.2 të nenit 17 të Ligjit nr.06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike, do të duheshin ofruar palës ankuese, jo më larg se shtatë ditë nga ata e pranimit të kërkesës për qasje në dokumente publike.

Siç është përshkruar në arsyetimin e lartcekur dhe bazuar në nënparagrafin 4 të nenit 20 të Ligjit Nr.067/L-081 për Qasje në Dokumente Publike, Agjencia ka nxjerrë vendimin e paraqitur në dispozitiv.

Këshillë Juridike:

Kundër këtij vendimi, pala e pakënaqur mund të paraqesë padi për kundërshtim në gjykatën kompetente për çështje administrative brenda 30 (tridhjetë) ditësh, nga data në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.



Jeton Arifi
Drejtor
Departamenti për Qasje
në Dokumente Publike

Vendimi i dërgohet:

- Z. Kastriot Bllaca, Zyrtar Përgjegjës, 'Termokos'
- OJQ 'Çohu', Ankuese
- Arkivit të Agjencisë